

BULETIN I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



Prill 2024

Përmbajtja:

- Shqipëria merr vendin e parë në Emiratet e Bashkuara Arabe për sigurinë kibernetike
- AKCESK mbështet bashkëpunimin rajonal në reagim të sulmeve kibernetike



Shqipëria merr vendin e parë në Emiratet e Bashkuara Arabe për sigurinë kibernetike

Shqipëria zë VENDIN E PARË në Kompeticionin Global të Sigurisë Kibernetike GISEC, që u zhvillua nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit) dhe Këshilli i Sigurisë Kibernetike të Emirateve të Bashkuara Arabe, në Dubai.

Ky kompeticion hyri në Librin Guinness, për shkak të numrit të lartë të vendeve pjesëmarrëse, nga ku Shqipëria nxori në pah ekspertizën dhe angazhimin serioz për të adresuar kompleksitetin e sigurisë kibernetike në një botë ku zhvillimet teknologjike kanë një shpejtësi marramendëse.

Shumë krenarë për përfaqësuesit e Shqipërisë nga AKCESK dhe AKSHI: Ilir Daka, Adriano Lleshi dhe Franc Zylftari që përfaqësuan me shumë dinjitet dhe profesionalizëm Shqipërinë përgjatë tre ditëve të aktivitetit, 23-25 prill 2024.

Eventi bëri bashkë ekspertë të sigurisë kibernetike, të apasionuar pas teknologjisë dhe institucione publike nga gjithë bota.



AKCESK mbështet bashkëpunimin rajonal në reagim të sulmeve kibernetike

Tryeza për Simulimin e Menaxhimit të një Krize Kibernetike Zv. Kryeministrja Belinda Balluku ndoqi nga afër simulimin e reagimit ndaj një krize kibernetike, organizuar nga AKCESK, në funksion të thellimit të bashkëpunimit dhe koordinimit mes institucioneve publike dhe private në raste të tilla.

E organizuar në Shtëpinë e Europës, kjo tryezë, e lehtësuar nga eGA dhe NUKIB, në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi Europian për rritjen e kapaciteteve në Ballkanin Perëndimor, bëri bashkë përfaqësues në nivel vendimmarrës të institucioneve si: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Ministria e Brendshme, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Prokuroria e Përgjithshme, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe përfaqësues nga sektori bankar.

Kjo tavolinë i shërben përpjekjes për të përgatitur një kuadër ligjor sa më të plotë si dhe ngritjen e një ekipi ekspertësh që do mund t'i përgjigjen sulmeve keqdashëse kibernetike në vend.

BULETINI I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



Prill 2024



Trajnimi teknik i AKCESK për Sigurinë Kibernetike në Institutin Kanadez të Teknologjisë (CIT)

AKCESK në bashkëpunim me Institutin Kanadez të Teknologjisë (CIT) organizoi një Trajnim Teknik dinamik për Sigurinë Kibernetike të mbajtur nga Z. Ergis Gaxho, Z. Gerald Bici dhe Z. Kristian Josifi, i koordinuar nga Assoc. Prof. Reis Mullita dhe Dr. Wassim Ahmad. Pjesëmarrësit fituan njohuri praktike për parandalimin esulmeve kibernetike dhe si të qëndrojnë përparatendencave në zhvillim të kërcënimit. Një pikë kryesore eseancës ishte përdorimi i platformës Cyber Drill, e cila ofroi një përvojë gjithëpërfshirëse simulimi kibernetik, duke i lejuar pjesëmarrësit të testonin aftësitë e tyre nënjë skenar realist të sulmit kibernetik.

Për të njohur angazhimin e tyre, të gjithë pjesëmarrësit morën një certifikatë pjesëmarrjeje nga AKCESK, duket heksuar përfundimin e tyre të trajnimit.



Takimi i AKCESK me përfaqësues të USAID & CPR

AKCESK ka zhvilluar një takim të frytshëm me përfaqësues të USAID Europe & Eurasia dhe përfaqësues të Programit CPR, të fokusuar në zhvillimin e strategjive të efektshme në cloud, si dhe në fuqizimin e kapaciteteve institucionale, veçanërisht të SOC Kombëtar.

Ky bashkëpunim shënon një hap të rëndësishëm në implementimin e asistencës teknike dhe strategjike nga partneri ynë strategjik, SHBA, si dhe dëshmon angazhimin e AKCESK për rritjen e nivelit të sigurisë në infrastrukturën e informacionit në nivel kombëtar.

Përmbajtja:

- Trajnimi teknik i AKCESK për Sigurinë Kibernetike në Institutin Kanadez të Teknologjisë (CIT)
- Takimi i AKCESK me përfaqësues të USAID & CPR
- Nexperia - data breach
- Microsoft Outlook - Patching Alert




Nexperia - data breach

Prodhuesi i çipeve Nexperia është vënë në shënjestër të hakerëve pasi Dark Angels, një grup ransomware, pretendoi se kishte vjedhur 1 TB të dhëna nga sistemet e tyre.

Këtu përfshihen të dhënat të kontrollit të cilësisë, dosje klientësh për gati 900 kompani, të dhëna konfidenciale të projektit, të dhëna të prodhimit industrial dhe informacione të korporatës. Kriminelët kibernetikë kanë bërë publike disa skedarë si provë, por kërcënojnë të nxjerrin të gjitha të dhënat e vjedhura nëse nuk paguhet një shpërblym. Nexperia ka shkëputur sistemet e prekura dhe ka nisur një hetim përta s i përket çështjes.

[Link: Lexo më shumë](#)

PATCHING ALERT



Microsoft Outlook - Patching Alert

Microsoft ka rregulluar një problem që shkakton alarme të gabuara sigurie të Outlook kur hapen skedarët e kalendarit. ICS pas përditësimeve të sigurisë së Desktopit të Outlook të dhjetorit 2023.

Përditësimet e sigurisë rregullojnë cenueshmërinë e zbulimit të informacionit të Microsoft Outlook CVE-2023-35636, të cilën sulmuesit mund ta shfrytëzojnë për të vjedhur hash-et NTLM nëpërmjet skedarëve keqdashëse.

[Link: Lexo më shumë](#)